



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1065/2 prot

Datë 03.05.2024

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E**  
**OFERTUESVE TË TJERË**

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Trimed” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr.REF-97233-03-04-2024 me objekt “*Loti 1 – Blerje materiale mjekimi per nevoja spitalore*”, me fond limit 6 533 020 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 26.03.2024 nga autoriteti kontraktor, Spitali “Ihsan Cabej” Lushnje.
- Ankimues:** BOE “Biometric Albania” SHPK & “Montal” SHPK, përkatësisht me NUIS J61827062E, J62009007F, me adresë: Bulevardi Zhan D'ark, Pallati 53, Ap 6b, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Spitali “Ihsan Cabej” Lushnje, me adresë: Lagja “Xhevedet Nepravishta, Lushnje.
- Subjekte të Interesuar:** Operatori ekonomik “Trimed” SHPK, me NUIS K51612031J, me adresë: Tiranë Kashar Autostrada "Tirane -Durres", Km 10, Zone Kadastrale 2105, Nr.Pasurie 95/11.,

Në datën 02.05.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1065/2024 protokoll dhe me numër ankimi elektronik A/2024/4040 e BOE “Biometric Albania” SHPK & “Montal” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr.REF-97233-03-04-2024 me objekt “*Loti 1 – Blerje materiale mjekimi per nevoja spitalore*”, me fond limit 6 533 020 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 26.03.2024 nga autoriteti kontraktor, Spitali “Ihsan Cabej” Lushnje.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Trimed” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë kriteret që BOE “Biometric Albania” SHPK & “Montal” SHPK pretendon se nuk përmbushen nga shoqëria Trimed” SHPK, të parashtruara në ankesën me nr. 1065 prot., datë 02.05.2024.

Konkretisht në ankesë pretendohet për mospërmbushje nga ana e operatorit ekonomik “Trimed” SHPK, të kriterëve si më poshtë vijon:

## **2.KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

2.3.2 *Operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë origjinën e mallit dhe kompaninë prodhuese. Te plotësohet ne Shtojcën 2. Lista e Çmimeve të artikujve të DST.*

2.3.5 *Ofertuesi duhet të paraqesë Çertifikate konformiteti CE sipas direktivës MDD 93/42 EEC, (të përditësuar) ose MDR, për të gjithë artikujt e ofruar, sipas kategorizimit të tyre, të përkthyer dhe të noterizuar ose certifikate FDA, të përkthyer dhe të noterizuar.*

2.3.6 *Ofertuesi duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi i mallrave ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi për territorin e Shqipërisë, ku në çdo rast të dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, për lejimin e tregëtimit të artikujve të tij. (të përkthyer dhe të noterizuar)*

2.3.8 *Kërkohen të paraqiten katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofruar. Në katalogë, artikujt dhe specifikimet teknike të tyre duhet të markohen me ngjyrë të ndezur sipas numrit rendor të përcaktuar në formularin e ofertës. (Katalogët duhet të ngarkohen në [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al) së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT.*

2.3.9 *Kërkohen të paraqiten mostra për të gjithë artikujt e ofruar. Dorëzimi i Kampioneve/ mostrave të bëhet pranë Spitalit “Ihsan Cabej” Lushnje, të mbyllura me ngjithëse në zarf/a ose kuti jo transparente të vulosur/a, mbi të cilin/at të shënohet: “Mos e hapni me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të kësaj procedure prokurimi dhe jo para datës **21.03.2024 ora 10:00***

- *Së bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti.*

- *Në paketimin e çdo mostre duhet të evidentohet qartë origjina e mallit e cila duhet të përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi në formularin e ofertës .*

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 03.05.2024

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Kryetar**

**Jonaid Myzyri**